



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/ KANCELARIJA ZA JAVNO KOMUNICIRANJE/  
OFFICE OF PUBLIC COMMUNICATION

**THIRRJE PËR APLIKIM  
PËR FERMERËT DHE EKONOMITË BUJQËSORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**PËR PËRFITIM NË KUADËR TË IMPLEMENTIMIT TË “PLANIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL 2007-13”, MBËSHTETJE  
PËR INVESTIME NË MASËN 8- STRATEGJITË PËR ZHVILLIM LOKAL TË BAZUAR NË KOMUNITETE - »PËRKRAHJE PËR  
ZHVILLIMIN E KOMUNITETIT LOKAL PËRMES GLV-ve«**

**I. Qëllimi i thirrjes për aplikim**

Qëllimi i thirrjes për të aplikuar është dhënia e ndihmës financiare/grantit për investime në kuadër të masës 8- Strategjitë për zhvillim lokal të bazuar në komunitete »Përkrahje për zhvillimin e komunitetit lokal përmes GLV-ve«.

**II. Përfituesit e pranueshëm**

Në përgjithësi, përfituesit nga kjo masë janë personat juridik (GLV - Grupet Lokale të Veprimit). Ato duhet të jenë të regjistruar në regjistrin e OJQ-ve, në Ministrinë e Administratës Publike dhe duhet të përmbushin kushtet sipas kësaj thirrje për aplikim.

**III. Investimet e pranueshme**

Për këtë masë investimet e pranueshme janë:

- ↳ **Infrastruktura bujqësore dhe rurale;**
  - Rregullimi i oborreve shkollore (rrethoja, ujësjellësi, fontana, parku i shkollës, hapja e puseve, fusha sporti),
  - Rregullimi i parqeve (investim i pranueshëm do të jetë gjithçka që është e nevojshme për rregullimin e parkut, përfshirë këndin e lojërave për fëmijë dhe terrenet sportive),
  - Rregullimi i varrezave (investim i pranueshëm do të jetë gjithçka që është e nevojshme për rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave përfshirë edhe rregullimin e rrugës deri tek varreza),
  - Rregullimi dhe pastrimi i shtratit të lumenjve,
  - Ndërtimi i ndonjë ure me interes të përgjithshëm,
  - Rregullimi i rrugëve rurale dhe fushore me karakter të përdorimit të gjerë (investim i pranueshëm e mbuluar me faturat e lëshuara nga një kompani e punëve përkatëse si kryese e punimeve);
- ↳ **Mirëmbajtja dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore në zona rurale;**
- ↳ **Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura;**
- ↳ **Përkrahje e ekspozitave me karakter bujqësor dhe artizanal;**
- ↳ **Përkrahje e projekteve me karakter zhvillimor ndërkufitar dhe manifestimeve ndërkufitare.**

Kostot pranueshme janë të gjitha ato që janë të faturuara prej kompanive të cilat janë të angazhuara për kryerjen e aktiviteteve!

#### **IV. Kriteri i pranueshëm**

Kushtet e pranimit duhet të plotësohet me rastin e dorëzimit të aplikacionit

##### **IV.1 Kriteri i pranueshëm**

1. Përfituesit duhet të dorëzojnë formularin e plotësuar për aplikim duke bashkangjitur dokumentacionin e vlefshëm/duhur për aplikim (Shtojca 1);
2. I tërë territori i Kosovës është i pranueshëm (i plotëson kushtet).

##### **IV.2 Obligimet e përfituesve**

1. Projekti i miratuar duhet të ndërmerret në afat prej 2 muajsh.
2. Përfituesi mund të bëjë/parashtrojë kërkesën **për më së shumti dy projekte! Projekti i dytë pranohet pasi që të jenë shërbyer të gjitha GLV-të me projektin e parë nëse veç i plotësojnë kushtet e kërkuara në thirrjen për aplikim!**
3. Aktivitetet e tyre duhet të jenë në përputhje me kërkesat dhe standardet për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me legjislacionin e tanishëm të Kosovës (pas përfundimit të projektit).
4. Përfituesi duhet t'i lejojë kontrollet nga institucionet përkatëse.
5. Përfituesi duhet të bëjë kthimin e grantit të pranuar nëse GLV nuk vepron në përputhje me kushtet e kontratës.

#### **V. Kostoja e pranueshme**

##### **V.1 Shpenzimet e pranueshme janë:**

- ☒ Shpenzimet e bëra për investime të pranueshme;
- ☒ Shpenzimet e bëra në përputhje me dispozitat e thirrjes së tanishme për aplikim;
- ☒ Shpenzimet e bëra pas marrjes së letrës informuese për miratim të projektit.

##### **V.2 Shpenzimet e papranueshme janë:**

- ☒ Taksat;
- ☒ Taksat e doganës dhe importit ose ndalesat tjera;
- ☒ Blerjet, qiratë ose lizingun e tokës ose ndërtesave ekzistuese;
- ☒ Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e gjyqit;
- ☒ Shpenzimet për blerjen e pajisjeve të përdorura;
- ☒ Ndalesat bankare, shpenzimet e garancive dhe ndalesat e ngjashme;
- ☒ Shpenzimet për operim dhe mirëmbajtje;
- ☒ Shpenzimet e bëra para publikimit të procedurës përkatëse të tenderimit;
- ☒ Shpenzimet në mall.

#### **VI. Dispozitat financiare**

Shpenzimet e projektit të pranueshme janë: a) minimumi 5000 € dhe b) maksimumi 10 000 €. Shpenzimet maksimale publike të kostove të pranuar të projekteve janë 70%. Nëse shpenzimet e investimeve të pranueshme janë më të larta se 10 000 €, atëherë mbi këtë shumë përfituesit duhet të ofrojnë mjetet e veta financiare për t'i mbuluar ato.

Pagesa do të sigurohet në llogarinë bankare të përfituesve brenda 60 ditësh pasi që GLV-ja të ketë bërë kërkesën për pagesë.

#### **VII. Koha dhe mënyra e marrjes së formularëve për aplikim**

1. Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita pasi të jetë publikuar thirrja për aplikim;
2. Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 45 ditë nga data e publikimit. Procedimi i aplikacioneve do të bëhet sipas parimit të kritereve të përzgjedhjes, të përcaktuara paraprakisht nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
3. Investimi duhet të kryhet në afat prej 60 ditëve nga data e aprovimit të projektit dhe të gjitha pagesat mbi shumën 500 € duhet të bëhen përmes transferit bankar;
4. Përfituesi duhet të shkojë në Zyrën Komunale për Bujqësi dhe të marrë dokumentet e nevojshme për të aplikuar;

5. Me përkrahjen e zyrtarit këshillues komunal ose vetë përfituesi bën plotësimin e formularit për aplikim dhe siguron dokumentet e nevojshme;
6. Formulari për aplikim dhe dokumentet e bashkangjitura duhet të dorëzohen në Zyrën Komunale për Bujqësi, çdo dit pune nga ora 09:00-15:30;
7. Zyrtari komunal për bujqësi në bazë të listës së posaçme kontrolluese, verifikon të gjitha dokumentet nëse ato janë në dispozicion dhe të vlefshme;
8. Nëse dokumentet janë në dispozicion dhe të vlefshme, atëherë zyrtari komunal për bujqësi bën pranimin e formularin për aplikimit, vulos atë dhe i jep numrin identifikues. Në rast se nuk janë të gjitha dokumentet në dispozicion dhe të vlefshme, atëherë zyrtari e kthen formularin e aplikimit. Është gjithashtu e mundur të pranojë formularin e aplikimit në rastin e dytë, nëse bartësi i GLV-së e firmos deklaratën se ai është në dijeni që nuk janë të gjitha dokumentet në dispozicion dhe të vlefshme;
9. Kur zyrtari komunal për bujqësi konstaton se aplikacioni i plotëson kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në thirrjen për aplikim, formulari për aplikim transferohet tek Njësia për Pagesa për t'u miratuar. Aplikantët e papranueshëm dhe/ose kërkesat e të cilëve janë gjetur të mos jenë në përputhje me dispozitat për aplikim edhe pas kërkesës së bërë për plotësim, do të njoftohen dhe transferohen tek Njësia për Pagesa.

### VIII. Procedurat e përzgjedhjes dhe konfirmimit

1. Sistemi i cili do të përdoret për t'u menaxhuar aplikacionet do të jetë sipas kriterëve të përcaktuara (sistemi i poentimit) nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural! Informacioni i plotë rreth kriterëve të përgjithshme është i bashkangjitur në materialin informues!
2. Aplikimet kontrollohen, përzgjidhen dhe vlerësohen nga Njësia e Pagesave brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e fundit e dorëzimit të aplikacionit, në kuadër të thirrjes aktuale për aplikim;
3. Pasi që aplikacioni të jetë kontrolluar sa i përket tërësisë dhe përshtatshmërisë, Njësia e Kontrollit kontrollon/verifikon aplikacionin në terren;
4. Përfituesi do të pranojë një letër njoftuese për miratimin apo vendimin për refuzimin e projektit (së bashku me arsyet);
5. Përfituesi duhet menjëherë të informoj Zyrën Komunale për Bujqësi për fillimin e investimeve (përjashtohen rastet për blerje të makinerisë);
6. Përfituesi, pas përfundimit të investimeve duhet të paraqitet në Zyrën Rajonale për ta plotësuar kërkesën për pagesë, në afat prej 15 ditëve pas përfundimit të investimeve.

### IX. Dokumentet e bashkangjitur

Projekti investues i cili duhet të përmbajë formë standarde të përmbajtjes së projektit;

Certifikata e regjistrimit të GLV-së;

Certifikata e numrit fiskal të GLV-së;

Kopja e letërnjoftimit të përfaqësuesit të autorizuar të GLV-së;

Dëshmia e sigurimit të 30% të investimeve nga kuvendet komunale, komuniteti, bizneset private, etj. (dëshmi nga kryetari i komunës ose përgjegjësi në sektorin financiar, nga biznesi privat bartësi i biznesit, bankës, kompanisë ose nga komuniteti me nënshkrim të të gjithë të interesuarve);

Dëshmia e shlyerjes së obligimeve të anëtarësisë ndaj rrjetit të GLV-ve;

Përfituesit duhet të kenë të hapur llogarinë të vlefshme bankare në emër të GLV-së;

Përfituesit duhet të jenë të regjistruar në Regjistrat e OJQ-ve, në Ministrinë e Administratës Publike.

### X. Kontaktet dhe pikat (vendet) informuese lidhur me aplikimin

<b>MBPZHR</b>				
Nga e hëna deri të premten nga ora 08:00-15:30				
1	Njësia e pagesave	Nehat Veliu	038 211 967	<a href="mailto:Nehat.veliu@ks-gov.net">Nehat.veliu@ks-gov.net</a>
2	Njësia e pagesave	Drita Bislimi	038 211 967	<a href="mailto:Drita.bislimi@ks-gove.net">Drita.bislimi@ks-gove.net</a>

3	Njësia e pagesave	Imer Limani	038 211 967	<a href="mailto:Imer.limani@ks-gov.net">Imer.limani@ks-gov.net</a>
<b>Drejtoria Komonale të Bujqësisë</b>				
Nga e hëna deri të premten nga ora 09:00-15:30				
Nr.	Komuna	Personi kontaktues	Telefoni	e-maili
1	Drenas	Halit Bytyqi		
2	Fushë Kosovë	Sylejman Shabani		
3	Prishtinë	Merita Tolaj		
4	Lipjan	Njazi Ibrahim		
5	Podujevë	Xhafer Sekiraqa		
6	Shtime	Ejup Ismajli		
7	Obiliq	Musli Mjeku		
8	Graçanicë	Goran Gjorgjeviq		
9	Dragash	Flamur Sylejmani		
10	Rahovec	Ilvi Derguti		
11	Mamushë	Jyksen Topojan		
12	Prizren	Jakup Kastrati		
13	Malishevë	Milaim Morina		
14	Suharekë	Shaqir Kryeziu		
15	Gjilan	Medin Zeqiri		
16	Viti	Fadile Demelezi		
17	Novo Bërd	Avdi Vllasaliu		
18	Kamenicë	Bektesh Dermaku		
19	Klllokot	Dosta Mesiq		
20	Partesh	Verica Milosheviq		
21	Ranilluk	Vlladimir Stojaniviq		
22	Ferizaj	Bashkim Mani		
23	Kaçanik	Zekirja Koxha		
24	Shtërpc	Fazli Islami		
25	Hani i Elezit	Selvet Shreta		
26	Mitrovicë	Bedri Bajrami		
27	Vushtrri	Avdyl Feka		
28	Skenderaj	Sabit Ferizi		
29	Leposavoq			
30	Zubin Potok			
31	Zveqan			
32	Junik	Ali Gacaferri		
33	Istog	Mujë Osmanaj		
34	Deçan	Bajram Çekaj		
35	Pejë	Mehdi Mula		
36	Klinë	Rexhep Rexhepi		
37	Gjakovë	Agron Zorra		